



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:086218

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05503193

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr./..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.. D.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.761/22 të datës 28.04.2022, pas mbajtës së seancës se shqyrtimit fillestar me datë 19.03.2024 në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit B.. D.., me datë 22.03.2024 mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datë 26.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.. D.., i lindur më datë ne K..... në N....., nga i ati I., e ëma F....., mbiemri i vajzërisë Z..., me vendbanim në S.. ne N., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, i identifikuar në bazë të pasaportës N..... me numër me numër personal, posedon numër te telefonit, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së N....., i pa dënua me parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Me datë 24.04.2022, rreth orës 23:00, në rr. "....." në P., pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge në atë mënyrë që, ditën kritike Policia e Kosovës, ishin në një pikë kontrolli ndalojnë veturën R... C..., të cilën e drejtonte këtu i pandehuri B.. D., dhe gjatë kontrollit në fijokën e veturës gjejnë substancë narkotike e cila pas verifikimit me pajisjen NarTest NTX 2000, ka rezultuar se e njëjta është substancë narkotike e llojit Marihuanë në sasi prej 0.7 gram, të cilën i pandehuri e kishte për konsum personal ku më pas substanca narkotike sekuestrohet.

- me çka ka kryer veprë penale *posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par. 2 te KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 81, 82, 69, 70, 71, 72, 440 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK- së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilin i pandehuri B.. D.. i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 0.7 gram.

Arsyetim.

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, kundër të pandehurit B D ka ngrit aktakuzë PP/II-nr.761/22 të datës 15.07.2022, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 te KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 19.03.2024 gjykata e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij.

Pas i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë dhe e ka njoftuar se me Kodin Penal të Kosovës, pranimi i fajësisë është paraparë si njëra prej rrethanave lehtësuese me rastin e caktimit dhe lartësisë së dënimit. Ky është favorimi mirëpo me pranimin e fajësisë nuk do të ketë procedurë të provave ku ju do te keni mundësi ti kundërshtoni provat e aktakuzës dhe njëkohësisht të merrni prova në mbrojtjen e juaj. Përfundimisht aktgjykimi në bazë të pranimit të fajësisë nuk mund të ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestarë ka deklaruar: pranoj fajësinë për veprë penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Ne vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te

pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi qe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit I. J. #5340 e dt. 24.02.2022; Emali i rreshterit H. B. #8584 e dt. 25.04.2022; Raporti i policit R. P. #7062 e dt.25.04.2022; Deklarata e të pandehurit B. D. e dhënë ne Stacionin Policor ne Pejë me dt. 24.02.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; Raporti i analizës se narkotikeve **NarTest** e dt. 27.04.2022; Foto-dokumentacion i veturës dhe substancës narkotike, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me dhënien fjalës përfundimtare të palëve, e me pas me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze te se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 269 par. 2 të KPRK-së .

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, i pandehuri me parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ka renë ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk ka gjetur

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me vërejtjen e shqiptuar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se e njëjta është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 0.7 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:086218, 26.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

G j y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.